



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.13

Prishtinë, më 30.3.2018, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla, Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Mufera Serbica Shinik, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Albert Kinolli dhe Duda Balje, anëtarë.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović-përfaqësues i OSBE-së, Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: koordinatorë - Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu, zjrtare e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit -**Igor Simiq**.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji, me amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit me amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, me amendamente të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, me amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06 L/011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamente të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034, me amendamente të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, para setë fillohet me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, paraqiti vërejtjen lidhur me mbajtjen e mbledhjes së komisionit më 27.03.2018. Njëherë kërkoi arsye kush e ka caktuar rendin e ditës dhe paraprakisht pse nuk është njoftuar apo konsultuar me të. Konsideron se është bërë shkelja e nenit 64 të Rregullores së punës, dhe kërkoi prej Administratës së Kuvendit që të ofrojë kërkesën enjë të tretës së anëtarëve të Komisionit, për thirrje të mbajtës së komisionit.

Kryetari, konstatoi se anëtarët e komisionit miratuan rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-037 për Metrologji, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit Funksional, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 5 (pesë) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 06/L-037 për Meteorologji, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-037 për Meteorologji dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e komunitetit serbë të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, me amendamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit Funksional, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 5 (pesë) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e komunitetit serb të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 5 (pesë) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e komunitetit serb të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim konkret në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 5 (pesë) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i Komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e komunitetit serb të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06 L/011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamente të Komisionit Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06 L/011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe konsideron se nuk ka vërejtje nga anëtarët e komisionit.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendante të Komisionit Funksional, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 5 (pesë) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr.06 L/011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr.06 L/011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e komunitetit serb të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034, me amendamente të Komisionit Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe konsideron se nuk ka vërejtje nga anëtarët e komisionit.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, dhe 5 (pesë) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet Kryetari i Komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e komunitetit serb të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

8. Të ndryshme.

Zoran Mojsilović, i informoi anëtarët e komisionit se jep dorëheqje si kryetar i grupit punues për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, për arsye se ka angazhime tjera dhe nuk mund të ofrojë kontribut të duhur.

Kryetari, dha propozim që në takimin e radhës së komisionit të ftohet ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, për të dhënë shpjegime lidhur me veprimet e policisë që ka ndodhur në pjesën veriore të Mitrovicës, më 26 mars 2018.

Duke iu referuar ngjarjeve në veri të Mitrovicës, ai tha se edhe një herë u dëshmuua se drejtësia nuk ekziston sepse dihet mirë se deputetët dhe ministrat duhet të kenë mbrojtje të veçant. Dhuna brutale që ka ndodhur me njerëzit, deputetët dhe ministrat është veprim i cili duhet dënuar. Për shkak se deputetët serbë votuan buxhetin në fund vitin e kaluar, policët kanë marrë paga dhe ata lejuan të shkelet drejtësia. Ne kemi paraqitur një kërkesë në Inspektoratin Policor të Kosovës për të analizuar dhe hetuar gjithçka që ka ndodhur dhe për të kërkuar përgjegjësi për ngjarjen e fundit që ka ndodhur.

Gjithashtu, dëshiron të informoi Komisionin se që nga dita e sotme Lista Serbe do të vepron si opozitë në Kuvend, dhe në ditët në vijim do të ketë mundësi të shihet se kush tjetër është opozitë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

Procesverbali u hartuan nga stafi mbështetës i Komisionit

Kryetar i komisionit,

Igor Simiq